

- Kërkesat e Qeverisë së Vlorës.
- Vlorë regeringens kraven
- XXX Propozimet e shteteve ballkanike.
- XXX Förslagen från den ballkaniska länderna
- Kufijtë e caktuar sipas vendimeve përfundimtare të Fuqive të Mëdha.
- Gränserna bestämda enligt de Stora Makternas slutliga beslut.

—•—•— Kufijtë e cinguar të shtetit shqiptar të caktuara nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, më 1913

—•—•— De stubbade gränserna av albanska staten bestämda av Ambassadorers Konferans i London, år 1913

Revistë kulturore - informative Shoqata Besa, në Trelleborg-Suedi
Kultur-och informationstidskrift Föreningen Besa i Trelleborg-Sverige

DRITA

Viti I
Nr. 7/96
Çmimi
30 :-

Sovrani i Shqipërisë, Princi Vilhelm Vid - kontrabandoi thesarin (e Shqipërisë?), më 09.08.1919, në Boste të Trelleborgut, në Suedi, në vlerë të prej 6 milion korona, që sot ka vlerën prej 84 milionë korona suedeze, ose përafërsisht 20 milion DM ! (Vlera në para të sodit u muarr nga Fëreningbanka, në Trelleborg).



(Uppgiften om dagens penningvärde är lämnade av Föreningbanken i Trelleborg)

Albaniens suverän, Prins Wilhelm av Wied, smugglade (albanska?) smycken för 6 miljoner kronor till Boste, utanför Trelleborg, den 09.08.1919, som idag är värda 84 miljoner kronor eller ungefär 20 miljoner DM !

LETRAT E LEXUESVE:**DRITA**Viti I
Nr. 7 / 96Kryeredaktor:
Chefredaktör:
SHEFKI OSEKURedaksia:
Kadrije Jashari
Shqiptar Oseku

Bashkëpunëtorë:

Hajdin Abazi
Zeçir Rama
Ullmar Qvick
Agron Danjoll
Rizah Sheqiri
Hazyr Dervishi
(Kosovë)KOMPJUTERIZIMIN:
Frashër Oseku

ADRESA/ADDRESS:

DRITA
C/O Shefki Oseku
Hamngatan 24
231 42 TRELLEBORG
SWEDEN

Tel (0)410 - 182 66

BANKKONTO:
(8214 - 9) 984.925.066 - 8Redaksia e mban të
drejtën e redaktimit.Të gjitha shkrimet
botohen vetëm në
gjuhën letrare.Shkrimet e fotografitë -
nuk kthehen.**DIKTATDIALOGU, AUTONOMISTËT
DHE REVOLTA E ATDHETARËVE****Hajdin Abazi**

Ndërsa shumica iu gëzua "marrëveshjes" Rugova-Milosheviq për "normalizimin e arsimit shqip", atdhetarët u revoltuan dhe shprehën hapur pakënaqësinë e tyre. Vallë, përse?

Sepse, dialogu i shumëpropaganduar nga liderët tanë, si kulm i rrugës paqësore dhe, në fund të fundit, edhe si logjikë e përfundimit të të gjitha konflikteve midis kombesh e shtetesh, do të duhej të përqëndrohej tek problemi kardinal, tek heqja e zgjedhës së robërisë serbe.

Por, nuk ndodhi kështu. Sepse dialog nuk pati. Ishte vetëm farsa e tij, karikatura e një dialogu të mundshëm. Ose, thënë më saktë, "dialogu" ishte **diktati** serb në akordim me atë ndërkombëtar. Ky imponim ishte koncesion ndaj konceptit serb, do të deklarojë Hydajet Hyseni, nënkryetar i LDK-së.

Gazetarët e masmediave shqiptare përgjithësisht u bënë trumbetarë të diktatdialogut, duke i ushqyer kështu iluzionet, sikur gjoja kjo marrëveshje do të trasojë rrugën drejt pavarësisë.

Ndaj, shtresa të ndryshme shqiptare e pritën me eufori e gëzim të ashtuquajturin "normalizim të arsimit shqip", duke besuar në atë që proklamohej.

Por, më shumë se askush tjetër u gëzuan ish-autonomistët dhe ata që kishin poste me levërdi, prej të cilave u larguan vetëm kur i dëboi me dhunë Serbia, duke kuptuar kahjen e kthimit mbrapa që po merrte lëvizja shqiptare, fërkuan duart, me shpresë se nuk do të shkonte shumë kohë kur do të riktheheshin sërish në ish-postet e tyre, në ato poste që për ta ishin vetë atdheu - pavarësisht se Kosova lëngonte nën robërinë serbe. Pikërisht këta janë ndër më të zjarrtit në justifikimin e diktatdialogut!

Vetëm atdhetarët, që kishin lënë vite të tëra të jetës së tyre nëpër burgje, që kishin përjetuar lloj-lloj tortura shtazarake nga pushtuesit serbë dhe lakejtë e tyre shqiptarë, me një qëllim të vetëm - për lirinë dhe pavarësinë kombëtare, qëllim ky me të cilin kanë lidhur jetën e tyre pandashëm, me ta marrë veshë karakterin parcial dhe sekondar të "marrëveshjes", shprehën revoltë, pakënaqësi, mospajtim dhe reaguesh, sepse atdhetarët mund t'i gëzohen vetëm fitores dhe jetësimi të pavarësisë, e kurrësi disfatës.

(7 shtator 1996)

Shefki!

Jag ber att överlämna tid. ex. via ett ombud!

Jag har läst de artiklar som är skrivna på svenska! Det var mycket intressant, samtidigt som jag berörs illa av vad de serbiska styrkorna företar sig. Det är mycket tragiskt.

Än en gång... tack för att jag fick titta i Er tidning. Kanske kan jag få höra vad Irene uttalar sig om... vid ett annat tillfälle.

Med vänlig hälsning



Philip

10.10.96

Për jetën:

Jeta e pa shfrytëzuar është vdekje e hershme.

Goethe

Ruam zot nga ujrat e qeta, nga ato vërshuese ruhem vetë.

fjalë e urtë spanjolle

Shumë pak njerëz jetojnë sot - shumica bëjnë përgaditje për të jetuar nesër.

Jonathan Swift

Të lindur origjinal, si ndodh që të vdesim si kopje.

Edward Yung

Të gjitha kafshët, përpos njerzëve, e dinë që domethënia e kësaj jete është që të kënaqesh me të.

Samuel Butler

Zoti që i kënaqur me punën e tij. Ky ishte gabimi i tij i madh.

S. Butler

Njeriu është një kafshë shoqëruese që urren ata që i ngjajnë atij

Delacroix

Zgjodhi dhe përktheu nga suedishtja

Qerim Maksudi

dhe çështja është mbyllur pa njohtime të mëtejshme.

Kombe që luftuan bashkë

Banorësinë finlandeze dhe pakicën suedeze në Finlandë i lidh një histori e gjatë e bashkëjetimit, e cila ka patur edhe episode të lavdishme epike, kur dy etnitë kanë luftuar krahu për krahu për lirinë e pavarësinë e vendit. Etnia suedeze ka dhënë ndihmë të spikatur në vet themelimin e idesë kombëtare e shtetërore të Finlandës, në krijimin e mendimit intelektual e në përkufizimin e atij politik të vendit si dhe në ravijëzimin e stabilizimin e Finlandës si e njohim sot.

Në këtë pikë, vrojtuesi i zgjuar mundet krejt lehtë të vërejë paralele të dukshme me rolin që p.sh. e ka lojtur etnia shqiptare në vendet fqinje, në Greqi me rastin e përpjekjes antiturke për pavarësinë e vendit dhe në trevat e ish-Jugosllavisë, sidomos gjatë LDB.

Ali Pasha Tepelena, i a.q. Luani i Janinës, sundimtar shqiptar i Shqipërisë së jugut dhe Greqisë së veriut në kohën e Perandorisë Osmane, qe prijësi më i parë në Siujdhesën Ilirike që dëshmoi vizion e ambicie të krijonte shtet të pavarur. Ai e toleroi qëllimshëm dhe madje edhe stimuloi procesin e vetëdijësimit nacional të kombit grek, duke dashur ta theksonte dallimin ndërmjet domenit të vet dhe trevave tjera të perandorisë. Luftat e tij antiturke në fund të shek. XVIII e ndezën shkëndijën e parë të atdhetarisë greke, që më në fund solli edhe deri te krijimi i Greqisë së sotme - në Greqi ka edhe sot për lot përmendore që kujtojnë shembëlltyrën madhështore e tragjike të sundimtarit shqiptar.

Paralelja tjetër identike me historinë shqiptare na kthen në kohën e LDB, kur kombi shqiptar i ofroi dhe i dha ndihmë vetëmohuese fqinjve të vet jugosllavë. Pasi e çliruan tërësisht hapësirën administrative të shtetit shqiptar të paraluftës (Shqipëria është i vetmi vend i Lindjes që u çlirua vetëm me forca të vetat!), formacionet shqiptare mobilizuan me shumicë bashkëkombas në trevat shqiptare dhe i vazhduan luftimet kundër trupave të Rajhut të Tretë

DRITA NR.7

gati deri te kufijtë më të epërm të ish-Jugosllavisë, deri në Srem të Vojvodinës në verilindje e deri në Istër në veriperëndim të ish-Jugosllavisë.

Mjerisht, këtu edhe përfundojnë paralelet ndërmjet përvojës historike të etnisë suedeze në Finlandë dhe përvojës historike të etnive shqiptare të mbetura jashtë kufijve të Shqipërisë politike.

Përvoja të rënda të shtypjes

Pas përfundimit të Luftës për Liri në vitet 1917-1918, të Luftës së Dimrit më 1939 dhe të Luftës së Vazhdimit në vitet 1941-1945, pakica etnike suedeze në Finlandë fitoi të drejta largvajtëse kombëtare, të cilat i kanë kënaqur maksimalisht kërkesat e saj të natyrshme për vetafirmim e komunikim të papenguar me vendim amë Suedinë.

Në anën tjetër, etnia shqiptare në vendet fqinje iu eksponua dhe ende po i ekspozohet një vargu të veprimeve gjenocidale, të cilat te shqiptarët kanë krijuar bindjen se qëllim i tyre final, në një perspektivë kohore, është zhbërja rrënjësore e tërë kombit shqiptar përmes çfarosjes dhe asimilimit.

Në Greqinë menjëherë pas pavarësisë, etnia shqiptare myslimane e kristiane përbënte rreth 30-40% të banorësisë së gjithsejme dhe, për shkak të pjesëmarrjes së vet vetëflijuese në luftën antiturke, ajo kish pozita mjaft të forta në shoqëri: dokumentat e parë të flotës greke janë p.sh. shumica dërrmuese të shkruar në gjuhën shqipe, për shkak të kuadrit këmbekrye shqiptar të kapitenëve e oficerëve në anije!

Se sa i fortë qe vizioni i një Greqie multi-kulturore menjëherë pas themelimit të vendit dëfton më së miri fakti sinjifikativ se në parlamentin e parë grek u desh të hidhej në votë nëse vendi i ri do të ishte dygjuhësor apo jo; në fakt, pra, votohej nëse vendi i ri do kishte apo jo një qasje të emancipuar ndaj diversitetit të trashëguar nacional të popullsisë.

-vijon në numrin e ardhshëm-

DRITA NR.7

DOKUMENTE

Kryeredaktori i revistës "DRITA", z. Shefki Oseku, bëri një zbulim interesant dokumentar. Për çka është fjala?

Më 29 korrik 1913, Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha vendosi që një princ gjerman të vihej në krye të shtetit shqiptar. Ky ishte princi Vilhelm Vidi, i propozuar nga Italia dhe Austro-Hungaria. Ai erdhi në Shqipëri më 7 mars 1914 dhe do të qëndrojë deri më 3 shtator 1914, kur do të largohet përgjithmonë nga Shqipëria. E, ç'ndodhë pesë vjet më pas me princ Vidin?

Më datën 9 gusht 1919 një aeroplan gjerman tentoi ta fusë kontrabandë thesarin e princ Vedit, në Bëste, në afërsi të Trelleborgut, Suedi. Aeroplani i lëshoi stolirat me dy thasë, ku i prisnin dy gjermanë, të cilët ishin dërguar nga Gjermania për këtë qëllim. Por, ky kontrabandim i çuditshëm, u zbulua papritmas nga peshkatarët, që rastësisht ndodhe-shin aty duke peshkuar. Mirëpo, kjo përpjekje për kontrabandimin e thesarit u shndërrua në një skandal gjyqësor ndër më famozët pas Luftës së Parë Botërore.

Më poshtë po japim fragmente nga dokumentet që flasin për këtë skandal.

"- lördagen den 9 augusti 1919 försökte en tysk flygmaskin att smuggla in smycken, juveler och pengar till ett värde av 6 miljoner kronor. Upptäcktes och lämnades till polisen. Tillhörde furst Wilhelm av Albanien" (*Presetasion av Böstehistoria, Trelleborgs Resebyrå*).

"Të shtunën, më 9 gusht 1919, një aeroplan gjerman tentoi të fusë kontrabandë stolira, margaritarë dhe para në vlerë prej 6 milionë koronash suedeze. U zbuluan dhe ju dorëzuan policisë. I takonin princit Vilhem nga Shqipëria" (*Të dhëna historike për Bøsten, dokument i Agjencisë Tursistike të Trelleborgut*).

"Lördagen den 9 augusti 1919 försökte en tysk flygmaskin smuggla in smycken och juveler till ett värde av närmare sex miljoner kronor genom att släppa ner dem över Bøste. Bland dem som uppteäckte detta var fiskaren Bror Gustavsson, kustvakten Joh. Lundh, polisen A. Krieger och kandidaten G. Jönsson-Ilien. Dyrbarheterna lär ha tillhört furst Wilhelm av Albanien. Händelsen blev föremål för en dikt av sign. Le Curieux i Trelleborgs-Tidningen: "Det mörknar över Bøste" (*Mårtensson, Eric: BÖSTE - ETT FISKELÄGE I VEMMENHÖGS HÄRAD, utgivet av Bøste Byalag, 1977, s. 19*).


"Të shtunën, më 9 gusht 1919, tentoi një aeroplan gjerman të fusë kontrabandë stolira dhe margaritarë në një vlerë rreth gjashtë milionë koronash, duke i hedhur ato mbi Bëste. Ndër ata që e panë këtë ishin peshkatarin Bror Gustavsson, roja e bregdetit Joh. Lundh, polici A. Krieger dhe kandidati G. Jonson Ilien. Ky thesar, me sa duket, i takonte princit Vilhelm nga Shqipëria. Kjo ngjarje u bë objekt për një poezi nga i nënshkruari Le Curieux, në Trelleborgs-Tidningen (Gazeta e Trelleborgut): "Errësohet mbi Bøste" (*Mårtensson, Eric: BÖSTE - ETT FISKELÄGE I VEMMENHÖGS HÄRAD, utgivet av Bøste Byalag, 1977, s. 19*).

DOKUMENTE

"Ingen visste, vilka fiskelägen (Böste fiskeläge - H. A.), som här funnos förborgade, förrän att tysk par upptäckte, att här var den ypperligaste platsen på flera mils avstånd att ostörda kunna taga emot ett regn från luften, d v s ett juvelregn. Fastän händelseförloppet inte artade sig i detalj som mottagarna beräknat, blev emellertid Böste lands- ja rent av världsberömt, ty till och med i amerikanska tidningar nämndes dess namn i samband med juvelregnet" (*Ur Böstge fiskeläge, Några drag ur lägets historia av Ellen Lund-Skarvik*).

"Askush nuk e dinte, se ç'vend me vlerë (vendpeshkimi në Böste - shën. H. A.) gjendej i fshehur këtu, para se një çift gjerman të zbulonte se këtu ishte një vend i shkëlqyeshëm, në një gjatësi prej disa miljesh, ku mund të pranohej pa pengesa një shi nga ajri, d.m.th. një shi margaritarësh. Ndonëse rrjedha e ngjarjeve nuk shkoi në detale sikurse kishin llogaritur pranuesit, Böste, ndërkaq, u bë një vend me famë botërore, sa, madje, edhe gazetë amerikane i përmend këta emra në lidhje me reshjen e margaritarëve" (*Nga libri "Böste - një vendpeshkim..."; Disa fragmente nga historia e vendit, prej Elen Lundh-Skarvik*).

Fotografi nga salla ku u mbajt
grykimi, më 19 shtator 1919.



Från rättegången måndagen den 29 september 1919. Fr. v. Rådman Jungbeck, t. f. borgmästare Ekstrand, försvarsadvokaten Lidfors, dr. Stockhausen, häradshövding Westman och tolken läroverksadjunkten J. Engstrand. Malmö.

"De (sidor av en bok om juvelregnet, - H. A.) förtälja en händelse, som förvisso är enastående i svenska tullverkets historia. Den var, kan man säga, en av världskrigets efterdyningar, men blev för de medagerande, den tyska grevinnan Anna zu Solms-Wildenfels och den tyske ingenjören Dr. Stockhausen jämte den långa raden angivare, kustvakten Lundh och fiskhandlaren Gustavsson, Böste, amanuensen Gösta Ilien, Lund, samt polisuppsyningsmannen Krieger, S. Åby, deras advokater samt övriga inblandade i det celebra tullmålet, ett minne för livet" (*Ur Juvelregnet av Ellen Lundh-Skarvik, s. 27*).

"Ato (faqet e një libri lidhur me margaritarët e princ Vidit, - shën. H. A.) rrëfejnë një ngjarje, e cila, sigurisht, është e pashembullt në historikun e dikasterit të doganës suedeze. Ajo ishte, mund të thuhet, një nga ngjarjet më të bujshme të pasluftës (është fjala për Luftën e Parë Botërore, - shën. H. A.), që do të mbahet mend për tërë jetën për bashkëvepruesit, si princesha gjermane Ana cu Solms-Wildenfels dhe inxhinieri gjerman Dr. Stokhausen, si dhe për denoncuesit: rojën bregdetare Lund dhe tregtari i peshqve

Fejtoni ynë:

ETNIA SUEDEZE NË FINLANDË

Në gazetën tonë do të mund ta lexoni në formë fejtoni këtë raport, të shkruar nga *Shqiptar Oseku* për nevojat e Ministrisë për Informacion të Republikës së Kosovës. *Etnia suedeze në Finlandë* u bë objekt interesimi edhe në kontekstin e ngushtë shqiptar pas deklaratave për shtyp të Raportueses së posaçme për të drejtat e njeriut në ish-Jugosllavi zj. Elizabeth Rehn, ku u ngrit paralelja në mes të gjendjes së etnisë suedeze në Finlandë me atë të banorësisë shqiptare të Kosovës. Titujt dhe nëntitujt janë të redaksisë. Në mungesë vendi, punimit iu hoqën fusnotat.

Si kemi cekur dhe më lart, banorët e ujdhesës i kishin dërguar një memorandum Mbretërisë Suedeze më 1918 duke lypur të bashkohen me të, mu në kohën kur Finlanda po luftonte dëshpërimisht kundër diversionit rus. Kërkesa e tyre u refuzua atëbotë nga një komision ndërshtetëror i Lidhjes së Kombeve.

Mirëpo, skandali i vendimit të padrejtë i shtyu diplomatët t'i impononin Finlandës kushte rigorozë. Lidhja e Kombeve kërkoi që finlandezët t'iu ofronin vendasve një mëvetësi largvajtëse dhe t'i respektonin "doket tradicionale të trevës", garanca këto që janë futur në trungun e ligjeve themelore të Finlandës.

Konjunkturën politike e ushtarake pas LDB e kanë forcuar edhe më tej pozitën e ujdhesës. *Åland* sot në fakt ka parlament të vetin dhe infrastrukturë krejt vendase të pushtetit lokal si nëpër komuna, ashtu edhe në shkallë të ujdhesës. Autoritetet anase vendosin për pjesën më të madhe të të hyrave tatimore si dhe për të gjitha investimet. *Åland* ka flamur të vetin dhe suedishten si gjuhë të parë. Ndikimi rus pas LDB iu ka imponuar Finlandës e Suedisë ujdhi ndërshtetëror, të cilat e kanë sanksionuar pozitën e ujdhesës si hapësirë të demilitarizuar nën mbikëqyrjen e Finlandës.

Mirëpo, statusi i këtillë i ujdhesës nuk ka mbetur i pasulmuar. Në Finlandë ka qarqe të fuqishme konservatore që qahen rregullisht për "padrejtësinë" që i është bërë vendit në *Åland* dhe që aty-këtu në mënyrë sporadike lëshojnë balona prove duke kërkuar fortifikimin ushtarak të ujdhesës.

Por, përçapjet e tyre deri tani kanë shkuar kot, pasi qëndrimi zyrtar rus në çështjen *Åland*, ashtu sikur edhe në çështjen e Kareleve, duket sikur është përfundimtar dhe i palëkundshëm.

Për lexuesin shqiptar është më interesant fakti se qarqet e lartpërmendura nuk janë të vetmet që janë të pakënaqura me statusin e ujdhesës. Ai sulmohet edhe nga një drejtim krejt tjetër, nga tendenca e spikatur prosuedeze e vet banorësisë së ujdhesës.

Më konkretisht, duket kthjelltë që aty ekziston edhe një rrymë e gjallë e ndikuere intelektuale që në platformën e vet politike duket e ka formuluar idealin e irridentizmit klasik, sado të moderuar në veprime. Kjo rrymë u ka sjellur kokëçarje të shpeshta formëdhënësve të politikës zyrtare si në Finlandë, ashtu edhe në Suedi; së fundi tani vonë, më 1994, kur kjo rrymë, në luftë me nenet e ujdive të moçme, shtypi të hollat e veçanta të ujdhesës.

Në opinionin suedez, akcioni i shtypjes të të hollave në *Åland* në vitin 1984 u prit, në mos me entuziazëm, aherë të paktën me simpati të pafshehur.

Krejt tjetër qëndrim dëftuan autoritetet e të dy vendeve. Policia finlandeze i gjurmoi dhe i zbuloi aktorët e akcionit, i konfiskoi tërë sasi të të hollave dhe shpalli fletarrest zyrtar kundër veprimtarit më të dalluar në këtë aferë, i cili u detyrua të ikë e të lypë strehim politik (sic!) në Suedi.

Përfundimisht, zyrtarë të të dy vendeve e kanë heshtur me vendosmëri tërë aferën

të punojë me të huaj, por unë vet e kam zgjedhur këtë detyrë. Unë, vazhdoi ajo, megjithatë i kam hetuar disa specialitete të qendrimit të të ardhurave këtu e që burojnë nga kulturat e ndryshme të popujve.

-Ta zëmë, njerëzit që vijnë nga ish shtetet komuniste, nuk ndërmarrin iniciativ, sepse janë mësuar t'iu programojnë të tjerët jetën e tyre, të ardhmen. Nga ana tjetër, njerëzit që vijnë nga vendet e Azisë lindore, posaçërisht gratë e tyre, e kanë zakon që të të falenderojnë shumë, madje edhe atëherë kur nuk është aspak i mirë për to propozimi jonë?! Kultura e këtyre e popujve të këtij rejonit është e tillë. Gruaja gjithnjë duhet të tregohet fisnike! Ndërkaq, kur është fjala për meshkujt e botës arabe, ata, pjesa dërmuese e tyre, e kanë vështirë t'i pranojnë urdhërat nga gratë! E siç dihet, në Suedi, shumicën e vendpunimeve administrative e zënë gratë.

-Në Trelleborg deri para tre vitesh ishin veç 5 familje shqiptare, kurse këto vitet e fundit janë bërë mbi 50 të tilla. Sigurisht se ju me të gjithë keni pasur kontakte. Ç'men dim keni krijuar për shqiptarët?

-Unë jam e kënaqur me të gjithë, papërshtatim. Në kontaktet e panumërta me ta e kam fituar përshtypjen se janë popull punëtor dhe se bëjnë përpjekje serioze që të arsimohen dhe të aftësohen për tregun e punës.

-Edhe një pyetje. A keni lexuar diç nga lehtësia shqipe?

- Mjerisht jo, por e kam ndërmend që këtë ta bëjë sa më parë.

-Ju falenderoj për bisedën e ngrohtë!
-Gjithashtu!

ARTISTJA NË ARTIZANATE

Margareta është njëra nga mësueset e ABF-it. E ka të kryer shkollën për arkatare të postës, ku edhe ka punuar 7 vite. Mirëpo, pas martesës i lindi djalë, Andersi, dhe kështu, kjo e ndërpreu punësimin.

Gjatë pesë viteve sa ishte në shtëpi kjo nuk ndejti duarkryq, por iu përvesh punës sistematike në përvetësimin e njohurive nga thurja, e artizanatet tjera, të cilën prirje e ki

shte trashëgim nga e ëma e besa edhe nga gjyshja e saj.

Ia filloi punën në ABF si mësime-dhënëse- thurse, ku punoi me një grup në javë. Pastaj u kualifikua për punëdore tekstilësh, kurse tani vonë, në vitin 1995, kjo e vijoi një kurs të veçantë për kompjuter. Meqë në ABF mësojnë grupmosha të ndryshme, kjo u jep mësime kompjuterik fëmijëve nga 5 deri në moshën 8 vjeç, pastaj grupit tjetër nga 8-12 vjeç.

Por, me këto që u thanë nuk pëshon veprimtaria arsimore e kësaj gruaje të vyeshme. Ajo u jep mësime plotësues edhe nxënësve me prejardhje të huaj, që është një projekt i hartuar në bashkëpunim mes Socialistit dhe Komvuxit.

- A ka mundësi të na thuani se cili qe motivi themelor që iu nxiti ta ndërtonit profesionin?

- Po të mos ishte dashuria ime ndaj artit, kontakti me të panjohurën, unë ju them sinqerisht se nuk do të ndihesha mirë. Arti i punëdoris është i tillë që të mëson për çdo ditë. Andaj unë e dua këtë punë.



(Margareta Svensson)

- Çfarë përshtypje keni nga kontakti me shqiptarët të cilët i vijnë kurset e ndryshme këtu, tek ju?

- Unë u jap mësime nga gjuha suedeze, dhe mund të them lirisht se nuk kam hasur në ndonjë vështirësi.

- A ju ka rënë të lexoni literaturë artistike nga gjuha shqipe?

- Po, disa krijime poetike. Më ka lënë mbresa Moikom Zeqo me poezinë "Çdo natë", pastaj Ali Podrimja "Unë biri yt, Kosovë", "Udhëtova që ta takoj një njeri". Pastaj poezia "Papyrus" e Selman Jusufit...

Do të ju zbuloj edhe një sekret: unë vet shkruaj poezi, andaj me kompetencën e poetit mund të them se poezitë më pëlqyen shumë.

DOKUMENTE

Gustavson, Boste, për nëpunësin Gosta Ilien, Lund, si dhe për mbikqyrësin policor Krieger, S. Åby, avokatët e tyre dhe të përzierit e tjerë në procesin e njohur gjyqësor të doganës" (Nga "Shi margaritarësh", Elen Lund-Skarvik).

"Sist vittnade justitierådet Meyer om fursten av Albanien exterritorialrätt i Tyskland samt hans undantagsställning vis a vis de tyska skattelagarna. (Grevinnan och doktorn hade nämligen förklarat, att fursten av Albanien alias furst Wilhelm av Wied var ensam ägare till smuggelgodset.) Slutligen påstod han även, att fursten var ensam ägare till dyrbarheterna" (Ur Juvelregnet av Ellen Lundh-Skarvik, s. 32).

"I fundit dëshmoi kryetari i Gjykatës Supreme Meyer mbi princin e Shqipërisë, ish-vend me të drejtën territoriale të Gjermanisë, si dhe për qëndrimin e tij mospërfillës kundrejt ligjeve gjermane të tatimit. (Princesha dhe doktori faktikisht patën shtuar se princi nga Shqipëria alias princ Vilhelmi nga Vidi ishte pronari i vetëm i thesarit të kontrabanduar.) Së fundi, ai pohoi edhe se princi ishte pronar i vetëm i thesarit" (Nga "Shi margaritarësh", Elen Lundh-Skarvik).

"Fursten af Albanien, hvilken hittills uppgifvits såsom ensam ägare till kostbarheterna, lär nämligen ej vara ägare till mera än omkring fjärdedelen af samtliga smycken" (Guldregnet vid Smyge - närmare sex miljoner, Trelleborgs-Tidningen, 20 augusti 1919).

"Princi i Shqipërisë, i cili gjer më tani paraqitej si i vetmi pronar i thesarit, faktikisht duket se nuk është pronar i më shumë se një të katërtës pjesë të stolirave" ("Shi i arit afër Smyges - afërsisht gjashtë milionë, shkrim në Gazetën e Trelleborgut, më 20 gusht 1919).

"Vi blandade dom sina fingrar i Albanerkonungens pund?"

(Le Curieux, de två sista raderna ur "Det mörknar över Boste", Trelleborg och slätten genom 50 år 1897 - 1954; Trelleborgs-Tidningen)

"Ata përzierin gishtërinjtë e vet në pundin e mbretit të Shqipërisë"

(Dy vargjet e fundit të poezisë "Errësohet mbi Boste" të Le Curieux)

"Den 17 maj kom utslag, vilket lydte ungefär så här: Svarandena återfår dyrbarheterna men åläggas 100 kronor i böter. Åklagaren fortsatt till hovrätten men med samma resultat, och hos högsta domstolen var sådan talan ej hörd" (Ur Juvelregnet av Ellen Lundh-Skarvik).

"Më 17 maj Gjykata mori vendim, që ishte përafërsisht kështu: Përgjegjësit i marrin thesaret, por paguajnë dënimin prej 100 koronash. Prokurori vazhdoi deri në Gjykatën e shkallës së dytë, por rezultati qe i njëjtë, kurse tek Gjykata Supreme nuk është bërë një padi e tillë" (Nga "Shi margaritarësh", Elen Lundh-Skarvik, f. 36).

Vallë, në këtë thesar të princ Vidit, a mund të jetë edhe një pjesë e thesarit të shtetit shqiptar? Këtë problem ua lëmë historianëve.

Më gjerësisht, lidhur me këtë zbulim, dokumentacionin etj. do të mund të lexoni në numrin e veçantë të DRITËS.

(Përgatiti: Hajdin abazi)

DOKUMENTE

DRITA NR.7

Guldregnet vid Smyge - närmare sex millioner

Värderingen slutförd. — Fursten af Albanien ej ensam ägare.

Värderingen af de vid Smyge huk pr flygmaskin införda tyska furstedyrbarheterna ha nu värderats. För dagen föreligga dessutom ett par intressanta nya rön i affären.

I de tvänne säckar, som utgjorde de nedkastade dyrbarheternas emballage, fanns ett antal försiglade konvoluter, som del uppgifves sju eller åtta stycken, hvilka voro försiglade med olika sigill och försedda med de olika ägarnas namn. Fursten af Albanien, hvilkens hittills uppgifvits såsom ensam ägare till kostbarheterna, lär nämligen ej vara ägare till mera än omkring fjärdedelen af samtliga smyckena. Vid nedkastningen från flygmaskinen hade en del af smyckena skadats. Sålunda hade stenar och pärlor såväl lossnat ur sina infattningar som ramponerats.

Värderingen af smyckena har nu slutförts och är, såsom förut nämnts, utförd af juveleraren Martin Lysell härstädes. Spelsarna hafva ännu icke värderats, men kunna vi omnämna att bland desamma finnes vackra prof: på gamla Valencienne och

Brüsselspetsar. Värderingssumman å enbart smyckena uppgår till närmare sex millioner kronor.

Smyckena bestå af diadem, collierer, hals- och hårsmycken, armband, broscher, örhängen, ringar, nålar, knappar m. m. En del af dessa äro synnerligen dyrbara, utvisande ett fint och vackert arbete, några däremot äro billigt kram, som ej kunnat värderas till mer än några kronor pr styck. Bland dessa sistnämnda funnos sålunda några helt simpla nysilversmycken och billiga arbeten af italiensk mosaik i oäkta infattning.

De dyrbaraste smyckena voro en pärlcollier samt ett diadem med därtill hörande collier, båda med briljanter och smaragder. Hvert och ett af dessa tre smycken representerar ett värde af omkr. en half million. Dessutom ingå i samlingen flera synnerligen vackra och dyrbara antika berlocker samt åtskilliga andra antika smycken med kaméer m. m., däribland ett med onyx-kaméer af orientalskt ursprung, hvilket utmärker sig för ett utsökt vackert arbete.

Handlingarna ha, i dag, överlämnats till tullskatten i Malmö. Och snart förde ridån komma att gå upp för äfventyrsdramats andra akt: Åtalet vid Trelleborgs rådhusrätt.

Faximil av Trelleborgs-Tidningen, den 20 augusti 1919, om affären om dyrbarheterna som tillhörde den albanska fursten Wilhem av Wied (från Tyskland), som en tysk flygmaskin försökte smuggla in den 9 augusti 1919.

Faksimil i Gazetës së Trelleborgut, të datës 20 gusht 1919, lidhur me skandalin e thesarit të princit shqiptar Vid (nga Gjermania), të cilin tentoi ta kontrabandojë nga një aeroplan gjerman më 9 gusht 1919.

përgjegjëse për studime dhe udhëzime profesionale të ardhacakve (Syo-konsulent), me të cilin rast zhvilluam një bisedë miqësore.

Kjo grua, siç më tregoi, është e punësuar këtu pas një përpjekjeje të mundimshme dhe vetëm vullneti i fortë i saj bëri që kjo të gjendet sot në këtë vendpunim: së pari me shkollë fillore punësohet në fabrikë. Pastaj punon si arkatare. Vijon kurrsin në Shkollën Komonale për të Rritur, ku e kryen gjimnazin. Më vonë e kryen edhe Shkollën e Lartë të Arsimit.

Edhe pse nënë e dy vajzave, Eirin, udhëtoi përçdo ditë nga 260 kilometra (5 orë në ditë!) për të vajtur e kthyer nga puna (Ishte e punësuar në Kristianstad e banonte në Trelleborg)!



(EIRIN ANDERSBERG)

Tek pas disa vitesh të mundimshme udhëtimi gjenë punë ku është edhe sot-si Udhëheqëse, Orientuese për Punë (sued. Arbestvegledare).

Meqë kjo punon për të huaj, e pyeta:

-Çfarë procedure ndiqet për ta punësuar një të huaj?

-Sapotardhurin e takoj përmes socialit. Atij i shtrohen pyetjet: çka punuar në vendlindje dhe ç'mendon të punojë këtu? Pastaj dërgohet në mësimin e gjuhës suedeze afro një vit(po edhe më tepër!)e tek pastaj unë ia dorëzoi Ndërmjetësuesit për Vendet e Punës(sued. Platsfärmedlare).

Ne jemi gjithsejt 24 veta që punojmë në Zyrën e Punësimit, e që kujdesemi për 2.200 të papunët faktik dhe për 400-500 të tjerë që vijonë kurse shkollore ose Universitete, e që hyjnë në grupin e të papunëve real.

DRITA NR.7

-A ka mundësi që për lexuesit tonë të na thuani se çfarë orari keni ju për palë?

-Palët i pranoj çdo ditë nga ora 9-15. Pas kësaj kohe telefonoj: në shkollë; në arkën e sigurimit; te palët që kanë thirrur tek unë por skam mundur t'iu përgjigjem më parë etj. Mirëpo, ndodhë të jem e zënë tërë ditën! E kjo sepse ne kemi mbledhje të përbashkëta: Sociali, Arsimit të Rritur, Zyrja e Punësimit Rajonal në Malme, Qendra Arsimore... e ku shqyrtohen të gjitha problemet e shkollimit dhe punësimit të të ardhurave.

-Cila është rruga më e mirë për të gjetur punë?

-Unë,tha Eirin, do t'i këshilloja të gjithë ata që me të vërtetë kërkojnë punë, që të:

-Kontaktojnë direkt me punëdhënësin;
-T'i përcjellin konkurset në gazetën tonë e gazetat tjera ditore që dalin në këtë rajon;

-Ta përdorin kompjuterin që gjendet në korridor tonë;

-Të kontaktojnë me Ndërmjetësuesin për Vendet e Punës:

-T'i përcjellin shpalljet të vendosura në muret e lokaleve tona...

Këto këshilla që i jep kjo grua i ka të bazuara. Kjo ka punuar mbi dhjetë vite me të huaj, gjë që që i ka sjellur njohuri e përvojë shumë të pasur jetësore.

-E kam konstatuar kaherë një fakt se të gjithë të huajtë duan të punojnë. Por disa janë më të gjallë, marrin inisiativë private, hapin shitore e zeytari private dhe kështu nuk janë më në social. Për të këtyllë neve japim edhe ndihma materiale në shuma të ndryshme, me qëllim që t'i nxisim njerëzit për jetë të pavarur.

-Gjatë gjithë kësaj kohe Ju keni takuar vese e zakone nga më të ndryshmet. A mund të na flisni se çka iu ka bërë përshtypje gjatë takimeve Tuaja me të huaj?

-Unë ka kohë që jam edukuar në frymën e mirëkuptimit ndaj kombeve e racave të tjera. Po u zbuloj një sekret-as unë vet nuk jam suedeze me origjinë por norvegjeze. Rrethanat familjare me kanë sjellë këtu dhe jam e lumtur për këtë përvojë jetësore të fituar. Mua nuk më ka detyruar shefi që

SI TË ARRIHET DERI TE PUNËSIMI?

Reportazhë nga Zyrja e punësimit

Në fillim punëtore e fabrikës, sot udhëheqëse e zyrës së punësimit; Nëna e dy fëmijëve që udhëtoi për çdo ditë nga 260 kilometra për të shkuar e ardhur nga puna; Trelleborgu i ka 1500 ndër marrje, megjithatë, 2280 veta kërkojnë punë dhe afro 500 të tjerë gjenden në shkolla e universitete; Ku dhe si mund të kërkojmë punë? Si i edukoi komunizmi njerëzit? Cila është kultura e grave të Azisë lindore? Po ajo arabe?

Shkruan: Shefki Oseku

Bah! sa kohë e keqe sot, më thoshte për çdo ditë një grua e moshuar kur hipte në karrikën afër meje, në të njëjtin autobus që na shpiente për në Ronneby. Një ditë, kur tanimë ishim bërë të njohur, iu drejtova:

- Ju e keni shtetin më demokratik në botë, mirëqenjen si rrallë kush në këtë planetë, mbrojtjen sociale poashtu të përmendur, e ne, atje në Kosovë, na vrasin, na helmojnë, na rrahin për hiç gjë. Vallë, çdo të bënim ne po të mos e kishim me bollëk - së paku këtë diell?

